

**SHOQËRIA "TERMOCENTRALI VLORE" SH. A, NIPT: K72422003G
RAPORT I AUDITUESIT LIGJOR DHE PASQYRAT FINANCIARE PËR VITIN E MBYLLUR
MË 31 DHJETOR 2019**

[Adresa: Porti i ri (Triport), Komuna Qendër, Vlorë]

Përmbajtja

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR.....	ii
I. Pasqyra e Pozicionit Financiar më 31 Dhjetor 2019.....	6
II. Pasqyra e Fitim/(humbje) dhe të Ardhurave Gjithpërfshirëse më 31 Dhjetor 2019.....	7
IV. Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019.....	9
V. Shënime Mbi Pasqyrat Financiare.....	10
1. Informacion i përgjithshëm.....	10
1.1 Aplikimi i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar të reja dhe të rishikuara (SNRF) 10	
2. Bazat e përgatitjes.....	11
3. Vlerësime dhe gjykime.....	12
4. Politikat Kontabël.....	13
4.1 Transaksionet në monedhë të huaj.....	13
4.2 Instrumentat financiarë.....	13
4.3 Grantet.....	15
4.4 Kapitali aksionar.....	15
4.5 Inventarët.....	15
4.6 Aktive afatgjata materiale.....	15
4.7 Aktivet afatgjatë jo-materiale.....	16
4.8 Aktive investuese.....	16
4.9 Zhvlerësimi i aktiveve jo-financiare.....	17
4.10 Zhvlerësimi i aktiveve financiare.....	17
4.11 Të ardhurat.....	17
4.12 Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit.....	18
4.13 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare.....	18
4.14 Tatimi mbi fitimin.....	18
4.15 Qiratë.....	19
4.16 Përfitimet e punonjësve.....	19
4.17 Transaksionet me palët e lidhura.....	19
4.18 Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara.....	19
5. Aktivet afatgjata materiale.....	20
6. Inventarë.....	21
7. Llogari të arkëtueshme e të tjera arkëtueshme.....	21
8. Shpenzime për t'u shpërndarë.....	21
9. Mjetet monetare.....	22
10. Kapitali.....	22
11. Hua afatgjata.....	22
12. Grante, të ardhura të shtyra dhe të tjera detyrime.....	23
13. Hua afatshkurtra nga KESH sh.a.....	23
14. Llogari të pagueshme tregtare.....	23
15. Detyrimet tatimore.....	24
16. Detyrime të tjera.....	24
17. Të ardhura nga shitja.....	24
18. Të ardhura të tjera.....	25
19. Materiale të para dhe të konsumueshme.....	25
20. Shpenzime personeli.....	26
21. Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi.....	26
22. Shpenzimet e tjera të shfrytëzimit detajohen si më poshtë:.....	26
23. Shpenzime interesi dhe të ngjashme e të tjera financiare.....	27
24. Rezultati Tatimore.....	27
25. Transaksionet me palët e lidhura.....	28
26. Manaxhimi i riskut financiar.....	29
27. Angazhime dhe detyrime të kushtëzuara.....	31
28. Ngjarje pas datës së raportimit financiar.....	31

I. Pasqyra e Pozicionit Financiar më 31 Dhjetor 2019

	shënime	Per vitin e mbyllur më 31.12.2019	Per vitin e mbyllur më 31.12.2018(rip.)
AKTIVET			
Aktivët afatgjatë		8,353,835,661	8,937,978,998
Aktivët afatgjatë materiale	5	8,353,835,661	8,937,978,998
Investime në Proçes		0	0
Aktivët afatgjatë jomateriale		-	-
		8,353,835,661	8,937,978,998
Aktivët afatshkurtra			
Inventare	6	720,320,387	886,960,449
Llogari të arkëtueshme tregëtare		0	0
Llogari të arkëtueshme e të tjera	7	82,528,598	68,728,633
Shpenzime për tu shperndarë	8	-	28,501,534
Mjetet monetare në arkë e në bankë	9	681,059,894	686,358,084
		1,483,908,879	1,670,548,700
Totali i aktiveve		9,837,744,540	10,608,527,698
KAPITALI DHE DETYRIMET			
Kapitali		(4,050,289,076)	(3,139,233,928)
Kapitali aksionar		31,204,000	31,204,000
Rezerva ligjore		1,560,200	1,560,200
Rezerva të tjera		225,747,682	225,747,682
Fitime/Humbje të mbartura		(3,397,745,810)	(3,057,833,142)
Fitimi /Humbje e ushtrimit		(911,055,149)	(339,912,668)
		(4,050,289,076)	(3,139,233,928)
Totali i kapitalit	10	(4,050,289,076)	(3,139,233,928)
DETYRIMET			
Detyrime afatgjatë		2,253,946,647	2,958,272,770
Hua afatgjatë	11	2,201,303,745	2,903,557,527
Grante,te ardhura të shtyra e të tjera detyrime	12	52,642,901	54,715,243
Detyrime të tjera afatgjatë		-	-
		2,253,946,647	2,958,272,770
Detyrime afatshkurtra		11,634,086,969	10,789,488,855
Hua afatshkurtra	13	10,798,867,357	10,088,944,810
Financime nga KESH -i	13.1	793,648,835	666,320,479
Llogari të pagueshme (furnitorë)	14	21,486,956	23,564,123
Detyrime Tatimore	15	1,791,780	2,425,655
Llogari të pagueshme të tjera	16	18,292,042	8,233,788
		11,634,086,969	10,789,488,855
Totali i detyrimeve		13,888,033,616	13,747,761,625
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		9,837,744,539	10,608,527,697

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 10 deri në 31, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Dorina KAMBERAJ
Hartues i pasqyrave financiare

Eduard ALUSHI
Drejtor i D. Ekonomike

Besnik KENDEZI
Administrator i TEC Vlorë sh.a

Vlorë, më .../.../2020

II. Pasqyra e Fitim/(humbje) dhe të Ardhurave Gjithpërfshirëse më 31 Dhjetor 2019

Shënime	Per vitin e mbyllur më 31.12.2019	Per vitin e mbyllur më 31.12.2018(rip.)
Te ardhura nga shitja energjise	17	-
Te ardhura te tjera	18	1,894,646
Materiale te para dhe te konsumeshme	19	(17,703,779)
Shpenzime personeli	20	(74,924,186)
Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi	21	(584,756,973)
Shpenzime zhvlerësimi	21	(258,367,176)
Shpenzime te tjera	22	(66,461,407)
Fitimi operativ	(892,191,876)	(1,000,318,874)
Te Ardhura /Shpenzime interesa Neto	23	(162,283,925)
Te Ardhura /Shpenzime kembimi Neto		822,690,131
Rezultati total financiare	(18,863,273)	660,406,206
Fitimi para tatimit	(911,055,149)	(339,912,668)
Efektet e tatimit te shtyre		-
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin		-
Fitimi i vitit	(911,055,149)	(339,912,668)
Te ardhura te tjera gjithëpërfshirëse		
Totali i te ardhurave te tjera gjithëpërfshirëse		-
Fitimi qe i atribuohet aksionareve te kompanisë mëmë		-
Totali i te ardhurave gjithëpërfshirëse qe i përket aksionareve te kompanisë mëmë	(911,055,149)	(339,912,668)

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 10 deri në 31, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Dorina KAMBERAJ
Hartues i pasqyrave financiare



Eduard ALUSHI
Drejtor i D. Ekonomike



Besnik KENDEZI
Administrator i TEC Vlorë sh.a.


Vlorë, më .../.../2020



III. Pasqyra e ndryshimeve në Kapital për vitin e mbylltur më 31 Dhjetor 2019

	Kapitali i aksionar	Rezerva ligjore	Rezerva te tjera	Fitime te Mhartura /Humbje te akumuluar	Fitim (humbje) e vitit financiar	Totali
Pozicioni më 01 Janar 2018	31.204.000	1.560.200	225.747.682	(3.057.833.142)		(2.799.321.260)
Transaksionet me pronaret Fitim(humbje) neto për periudhën kontabël 2018					(339.912.668)	(339.912.668)
Riparaqitje Pozicioni më 31 dhjetor 2018	31.204.000	1.560.200	225.747.682	(3.057.833.142)	(339.912.668)	(3.139.233.928)
Pozicioni më 01 Janar 2019	31.204.000	1.560.200	225.747.682	(3.057.833.142)	(339.912.668)	(3.139.233.928)
Sistemim veprimi Miratimi i rezultatit te vitit 2018				(339.912.668)	339.912.668	-
Sistemim humbja e akumuluar Transaksionet me pronaret					(911.055.149)	-
Fitim(humbje) neto për periudhën kontabël 2019					(911.055.149)	(911.055.149)
Pozicioni më 31 dhjetor 2019	31.204.000	1.560.200	225.747.682	(3.397.745.810)	(911.055.149)	(4.050.289.077)

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 10 deri në 31, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Dorina KAMBERAJ

Hartues i pasqyrave financiare

Eduard ALUSHI

Drejtor i D. Ekonomike

Besnik KENDEZ
Administrator i TEC Vlorë sh.a



Vlorë , më .../...../2020

IV. Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

	Per vitin e mbyllur më 31.12.2019	Per vitin e mbyllur më 31.12.2018(rip.)
Fluksi monetar nga veprimtaritë e shfrytëzimit	(122,921,040)	(209,716,542)
Fitimi para tatimit	(911,055,149)	(339,912,668)
Shuma e mare nga Permbarimi	-	-
Rregullime për:		
Amortizimin i AAM	584,143,337	584,756,973
Zhvleresimi i Llog.arketueshme		
Efekte nga kursi Kermbimit per Huate	(109,954,084)	(869,137,125)
Efektet e tatimit te fitimit		
Te ardhura nga grantet dhe subvencionet	(2,072,342)	(1,894,646)
Vlera kontabel neto e aktiveve te shitura	-	-
Efektet e tatimit te shtyre	-	-
Levizjet ne Kapitali Qarkullues		
Rritje(-)/rënie(+) në tepricën e kërkesave të arkët	(13,799,965)	(10,116,362)
Rritje(-)/rënie(+) në tepricën e shpenzime per tu shperndare	28,501,534	(811,035)
Rritje/rënie në tepricën inventarit	166,640,062	250,469,150
Financim te tjera te KESH	127,328,356	177,522,276
Rritje/rënie në llogarite e furnitoreve	(2,077,167)	(5,046,228)
Rritje/rënie në llogarite te tjera te pagueshme	10,058,254	4,392,674
Rritje/rënie në marrëdhëniet me buxhetin	(633,876)	60,449
Mjetet Monetare neto nga aktivitetet e shfrytëzimit	(122,921,040)	(209,716,542)
Fluksi monetar nga veprimtaritë investuese		
Blerja e aktiveve afatgjata material	-	(460,000)
Rivleresimi i asetëve	-	-
Të ardhura nga shitja e pajisjeve	-	-
Mjete Monetare neto e përdorur në aktivitetet investuese	-	(460,000)
Fluksi monetar nga veprimtaritë financiare		
Flukset monetare nga ndryshimet ne kapital (neto)		
Hua te arketuara/paguar (neto)	117,622,849	164,563,013
Mjete Monetare neto e përdorur në aktivitetet financiare	117,622,849	164,563,013
Rritja (+)/rënia(-) neto e mjeteve monetare	(5,298,191)	(45,613,529)
Mjetet monetare në fillim të periudhës kontabël	686,358,084	731,971,612
Mjetet monetare në fund të periudhës kontabël	681,059,893	686,358,084

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 10 deri në 31, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Dorina KAMBERAJ
Hartues i pasqyrave financiare

Eduard ALUSHI
Drejtor i D. Ekonomike

Besnik KENDEZI
Administrator i TEC Vlorë sh.a

Vlorë, më .../.../2020

Riparaqitje e Pozicionit Financiare sipas SNK Nr. 1.

Në pasqyrat financiare të vitit 2018 është riparaqitur humbja e akumuluar dhe tatimi fitimi.

Përshkrimi	Debitohet Lekë	Kreditohet Lekë	Komente
109-Rezultati i ushtrimit 2018	23,563,406		Riklasifikim veprimi, pa efekte financiare.
444-Tatim mbi fitimin 2018		23,563,406	Riklasifikim veprimi, pa efekte financiare.

Veprimi kontabël më sipër nuk ka efekte financiare.

V. Shënime Mbi Pasqyrat Financiare

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria "Termocentrali Vlorë" sh.a është krijuar juridiksht me vendimin e Gjykatës nr. 3862, datë 18.06.2007 si dhe është regjistruar në QKR më datën 22.12.2007.

Selia e Shoqërisë ndodhet në Portin e ri, "Komuna Qender", Vlorë.

NIPT-i i Shoqërisë është K72422003G.

Administratori i Shoqërisë është Z.Besnik Këndezi.

Aktiviteti kryesor i kësaj shoqërie është prodhimi, importi, eksporti dhe furnizimi i energjisë elektrike .

Shoqëria është një shoqëri aksionere me një kapital prej 31,204,000 Lekë, i ndarë në 31,204 aksione me vlerë nominale prej 1,000 Lekë.

Numri i të punësuarve deri më 31.12.2019 është 62punonjes [2018-62].

Referuar Nenit 4 të Ligjit 25/2018 dt.10.05.2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare"TEC-Vlora" kategorizohet në: njësi ekonomike e **mesme**.

Kuadri ligjor: Ligjit Nr.25/2018 dt.10.05.2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare".

Pasqyrave Financiare janë hartuar sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit.

Kohëzgjatja e periudhës raportuese është 12 muaj: 01.01.2019-31.12.2019.

Keshilli Mbikqyres përbëhet:

- Tritan Brahimaj - kryetar
- Fitnete Koçiaj - anëtare
- Ermira Teliti - anëtare
- Olta Cenaj - anëtare
- Erideta Bashi - anëtare
- Romeo Kara - anëtar

1.1 Aplikimi i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar të reja dhe të rishikuara (SNRF)

Standardet dhe interpretimet efektive ne periudhen aktuale

Adoptimi i SNRF 16 "Qiratë"

- SNRF 16, Qiratë (publikuar më 13 janar 2016 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019). Standardi i ri përcakton parimet për njohjen, matjen, prezantimin dhe paraqitjen e qirasë. Të gjitha qiratë pothuajse rezultojnë që qiramarrësi të ketë të drejtën e përdorimit të një aktivi në fillim të qirasë dhe, nëse pagesat e qirasë bëhen përgjatë kohës të marrë edhe financim. Rrjedhimisht, SNRF 16 eliminon klasifikimin e qerave si qera operationale ose qira financiare siç kërkohet nga SNK 17 dhe, në vend të kësaj,

prezanton një model të vetëm të kontabilitetit të qiramarrësit. Qiramarrësi do të kërkohet që të njohë: (a) aktivet dhe detyrimet për të gjitha qiratë me një afat më të gjatë se 12 muaj, përveç nëse aktivi në fjalë është me vlerë të vogël; dhe (b) zhvlerësimin e aktiveve të marra me qira veç nga interesi për detyrimet e qirasë financiare në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse. SNRF 16 në thelb ka të njëjtat kërkesa me SNK 17 për trajtimin kontabël të qirave në këndvështrimin e qiradhënësit. Ndaj, një qiradhënës vazhdon të klasifikojë qiratë e tij si qira të zakonshme ose qira financiare dhe të bëjë llogaritjet bazuar në llojin e qirasë.

- Ndryshimet në SNRF 9 "Instrumentat Financiarë"- Veçoritë e Parapagimit me Kompensim Negativ (efektiv më ose pas datës 1 Janar 2019);
- Ndryshimet në SNRF10 "Pasqyrat Financiare të Konsoliduara" dhe SNK 28 "Investimet në pjesëmarrje dhe sipërmarrjet e përbashkëta" -Shitja apo Kontributi i aseteve mes një Investitori dhe bashkëpunëtorëve të tij, ose sipërmarrje të përbashkëta dhe ndryshimeve të mëtejshme (data efektive e shtyrë për kohë të pacaktuar derisa projekti kërkimor mbi metodën e kapitalit neto të jetë përfunduar);

Standardet, amendamentet dhe interpretimet e standardeve ekzistuese që nuk janë ende në fuqi dhe nuk janë miratuar më herët nga Shoqëria.

- Ndryshimet në SNK 1 "Paraqitja e Pasqyrave Financiare" dhe SNK 8 "Politikat Kontabël, Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël dhe Gabimet"-Përkufizimi i Materialit (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2020).
- Ndryshimet në SNRF 3 "Kombinimet e Biznesit" - Përkufizimi i një Biznesi (efektiv për kombinime biznesi për të cilat data e blerjes është në ose pas fillimit të periudhës së parë vjetore të raportimit që fillon më ose pas 1 Janarit 2020 dhe për blerjet e aktiveve që ndodhin në ose pas fillimit të asaj periudhe).
- Ndryshimet në Referencat në Kuadrin Konceptual në Standardet e SNRF (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2020); SNRF 17 "Kontratat e Sigurimit" (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas Janarit 2022);

Shoqëria ka zgjedhur të mos miratojë këto standarde të reja dhe ndryshime në standardet ekzistuese përpara datës kur hyjnë në fuqi. Shoqëria parashikon që adoptimi i këtyre standardeve dhe ndryshimet në standardet ekzistuese nuk do të kenë ndikim material në pasqyrat financiare të Shoqëria.

2. Bazat e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të publikuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ("IASB") dhe interpretimeve të publikuara nga Komiteti i Interpretimeve të Raportimeve Financiare Ndërkombëtare ("IFRIC") të IASB.

Pasqyrat financiare janë përgatitur duke përdorur bazat e vlerësimit të specifikuara nga SNRF për çdo klasë të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave gjithëpërfshirëse. Bazat e matjes përshkruhen në detaje në politikat kontabël të më poshtme.

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon përdorimin e disa çmuarjeve kritike kontabël. Gjithashtu kjo kërkon që drejtimi të përdorë gjykimin e tij në procesin e përdorimit të politikave kontabël të Shoqërisë. Fushat që përfshijnë një nivel të lartë gjykimi apo kompleksiteti ose fushat ku supozimet dhe çmuarjet janë të rëndësishme për pasqyrat financiare paraqiten në shënimet përkatësisht.

Pasqyrat financiare janë përgatitur për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019.

Të dhënat aktuale në këto pasqyra financiare janë të shprehura në Lek.

Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Krahasueshmëria

Informacioni krahasues paraqitet në mënyrë të vazhdueshme, duke aplikuar politikat kontabël të Shoqërisë dhe duke u bazuar në modelin e pasqyrave financiare sipas Standarteve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek Shqiptar ("Lek"), e cila është monedha funksionale e Shoqërisë.

3. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

Vlerësimi i drejtimit për vijimësinë e aktivitetit të Shoqërisë

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj në një të ardhme të parashikuar.

Për vitin 2018 dhe për vitin 2019, duke qënë se TERMOCENTRALI VLORE sh.a. nuk është në funksion, Enti Rregullator i Energjisë ("ERE") nuk i ka miratuar një çmim prodhim të energjisë dhe për pasojë as kuotën fikse mbi bazen e të cilit TEC-i financohej nga Korporata Elektroergjitime Shqiptare. Për rrjedhojë edhe për vitin 2019 shoqëria nuk ka realizuar të ardhura dhe është me rezultat negativ. Mbulimi i shpenzimeve të TEC Vlorë bëhet nga KESH sha.

Në rast të vazhdiminimit të mosfunksionimit të TEC-it, shoqëria mund të vendoset përballë vështirësive financiare dhe bllokimit të aktivitetit të saj por mbulimi i shpenzimeve të TEC Vlorë sh.a. do të bëhet nga KESH sha.

Shoqëria "Termocentrali Vlorë" sha është një investim i KESH sha prej rreth 100 mln Euro që nga koha e marrjes në dorëzim është jashtë funksionit dhe nuk ka realizuar asnjë të ardhur nga shitja e energjisë, qëllimi për të cilën ai është ndërtuar.

Gjykime dhe vlerësime mbi efektet e pandemisë në parimet e vijimësisë

Ndërsa situata pandemike COVID-19 ende po evoluon në Shqipëri dhe në mbarë botën, ka pasiguri të lartë mbi shtrirjen e saj në kohën e lëshimit të këtyre pasqyrave financiare. Si pasojë,

menaxhimi nuk është në gjendje të vlerësojë me siguri dhe të sigurojë një vlerësim sasior të ndikimit të mundshëm të kësaj pandemie në kompani.

Provizionet

Një provigjon njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim aktual ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe është e mundur që flukse dalëse të përfitimeve ekonomike do të përdoren për shlyerjen e detyrimit. Provigjonet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për rreziqet specifike të detyrimit. Ndryshimi i skontimit për shkak të vlerës në kohë të parasë njihet si kosto financimi

4. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

4.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e pasqyrave financiare. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisht të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 është detajuar si më poshtë:

	<u>31.12.2019</u>	<u>31.12.2018</u>
Kurse e këmbimit		
Euro/Leke	121.77	123.42
USD/Leke	108.64	107.82
GBP/Leke	143.00	132.98

4.2 Instrumentat financiarë

4.2.1 Aktivitetet financiare joderivative

Shoqëria fillimisht njihet llogaritë e arkëtueshme financiare, tregtare dhe të tjera, dhe depozitat në datën që ato krijohen. Të gjithë aktivitetet e tjera financiare njihen fillimisht në datën e tregtimit, kur Shoqëria bëhet palë e kushteve kontraktuale të instrumentit.

Shoqëria regjistron një aktiv financiar kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur Shoqëria transferon të drejtën kontraktuale për të marrë flukset e parasë nga aktiviteti financiar në një transaksion në të cilin gjithë rreziqet dhe përfitimet nga pronësia e aktivitetit financiar transferohen. Çdo interes në aktivitetet financiare të transferuara që krijohet apo mbahet nga shoqëria, njihet si një aktiv apo detyrim i veçantë.

Aktivitet dhe detyrimet financiare paraqiten me vlerë neto në pasqyrën e pozicionit financiar atëherë vetëm atëherë kur Shoqëria ka një të drejtë ligjore për të netuar shumat e tyre, dhe ka për qëllim ose të shlyejë shumën neto, ose të realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht.

4.2.2. Llogaritë e arkëtueshme financiare, tregtare dhe të tjera

Llogaritë e arkëtueshme financiare, tregtare dhe të tjera janë aktive financiare me pagesa fikse apo të përcaktueshme të cilat nuk janë të kuotuar në një treg aktiv. Aktive të tilla njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus kostot të lidhura direkt me transaksionin. Pas njohjes fillestare llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv pakësuar me humbjet nga zhvlerësimi.

Shoqëria gjithmonë e mat provigjonin për llogaritë e arkëtueshme në një shumë të barabartë me humbjet e pritshme të përgjatë gjithë jetëgjatësisë. Humbjet e pritshme për llogaritë e arkëtueshme përllogariten duke përdorur një matricë provigjonimi me referencë nga eksperiencia e kaluar e mosshlyerjes nga ana e klientit dhe nga një analizë e pozicionit aktual financiar të tij, e rregulluar për faktorë që janë specifike për klientin, kushtet ekonomike të përgjithshme të industrisë në të cilën klientët operojnë dhe një vlerësim i rrjedhës së parashikuar dhe aktuale të kushteve në datën e raportimit.

Nuk ka ndodhur asnjë ndryshim në teknikat e vlerësimit apo në supozime të rëndësishme gjatë periudhës aktuale të raportimit. Shoqëria njih një fond provigjoni kur ka informacion që tregon se klienti është në vështirësi financiare dhe nuk ka një perspektivë realiste të rimëkëmbjes, p.sh. kur klienti është proces likuidimi ose ka hyrë në procedura të falimentimit, ose kur një llogari e arkëtueshme është mbi dy vjet e pashlyer, cilado që të ndodhë më herët.

4.2.3. Mjetet monetare dhe ekuivalentet me to

Mjetet monetare dhe ekuivalentet me to përfshijnë mjetet monetare gjendje dhe depozitat me afat fillestar maturimi jo më të madh se tre muaj. Overdraftet bankare, që janë të ripagueshme sipas kërkesës dhe përbëjnë një pjesë të rëndësishme të menaxhimit të mjeteve monetare të shoqërisë, përfshihen në mjetet monetare dhe ekuivalentet me to në pasqyrën e flukseve monetare.

4.2.4 Detyrimet financiare joderivative

Shoqëria fillimisht i njih detyrimet financiare në datën e tregtimit, kur Shoqëria bëhet palë e kushteve kontraktuale të instrumentit.

Shoqëria e çregjistron një detyrim financiar kur detyrimet e tij kontraktuale shlyhen ose anulohen apo përfundojnë.

Aktivitet dhe detyrimet financiare paraqiten me vlerë neto në pasqyrën e pozicionit financiar atëherë dhe vetëm atëherë kur Shoqëria ka një të drejtë ligjore për të netuar shumat e tyre, dhe ka për qëllim ose të shlyejë shumën neto, ose të realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht.

Detyrimet financiare joderivative të Shoqëriat janë si vijon: hua dhe llogari të pagueshme tregtare dhe të tjera.

Këto detyrime financiare njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus kosto të lidhura direkt me transaksionin.

Për huatë e marra drejtpërdrejt nga bankat ndërkombëtare të zhvillimit(KESH), norma e tregut përcaktohet duke u nisur nga perspektiva e bankave të zhvillimit dhe përgjithësisht është e barabartë me normën e kontratës, për shkak se bankat e zhvillimit përbëjnë tregun për Shoqërinë.

Për fondet e financuara fillimisht nga bankat ndërkombëtare të zhvillimit dhe më pas të nën-huazuara tek KESH nga Qeveria për TEC Vlora, norma e tregut është përcaktuar fillimisht duke iu referuar normave të ofruara nga bankat ndërkombëtare të zhvillimit. Diferenca midis vlerës së

drejtë në momentin e njohjes fillestare dhe vlerës nominale të huasë konsiderohet si kontribut nga aksionari dhe kontabilizohet si rezervë rivlerësimi në kapital.

Pas njohjes fillestare këto detyrime maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e normës efektive të interesit.

4.3 Grantet

Grantet njihen fillimisht si të ardhura të shtyra kur ka një siguri të arsyeshme se ato do të merren dhe që Shoqëriado të jetë në përputhje me kushtet që i janë bashkëngjitur atyre. Grantet që kompensojnë shpenzimet e ndodhura të Shoqëriat, njihen në mënyrë sistematike në fitim ose humbje në të njëjtën periudhë në të cilën ndodhin shpenzimet. Grantet që kompensojnë Shoqëria për koston e aktiveve, njihen në mënyrë sistematike në fitim ose humbje përgjatë jetës së dobishme të aktivit.

4.4 Kapitali aksionar

Aksionet e zakonshme klasifikohen si kapital. Kapitali aksionar njihet me vlerën nominale.

Dividendët

Shpërndarja e dividendëve për aksionarin njihet në pasqyrat financiare të shoqërisë si detyrim në periudhën në të cilën aprovohen nga aksionari shoqërisë.

4.5 Inventarët

Inventarët vlerësohen me vlerën më të vogël mes koston dhe vlerës neto të realizueshme. Kosto e inventarit përfshin shpenzimet e njohura gjatë blerjes së inventarit, prodhimit ose koston së tjetërsimit dhe kostove të tjera shtesë të njohura për ruajtjen dhe sjelljen në pozicionin ekzistues të inventarit. Në rastin e inventarit të prodhuar dhe prodhimit në proces koston përfshijnë një marzh të kostove shtesë prodhuese, bazuar në operimin me kapacitet normal. Vlera neto e realizueshme është ekuivalente me diferencën e cmimit të shitjes së parashikuar, në rastin e një veprimtarie normale të biznesit me koston totale të parashikuara dhe shpenzimet e shitjes.

4.6 Aktive afatgjata materiale

Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin(+/-) dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale. Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të

besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

Amortizimi

Amortizimi i aktiveve Afatgjatë Materiale (AAM) llogaritet me **metodë linare** sipas jetës së vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material për:(i) Ndërtesa; (ii) Ndërtesa dhe Instalime; (iii) Makineritë e Pajisjet duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes, Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2019 dhe 2018 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Amortizimi
Ndërtesa	50 vite
Ndërtime dhe instalime	20-50 vite
Makineri dhe pajisje	15-25 vite

Kjo metodë zbatohet për asetet e transferuara nga KESH sh.a. në vitin 2012. Gjithashtu ekziston një grup asetesh në klasën Makineritë e Pajisjet të cilat janë blerë nga shoqëria vit pas viti, amortizimi i të cilave llogaritet me **metodën e amortizimit të vlerës së mbetur**.

Ndërsa:(i)Mjetet e Transportit;(ii)Pajisjet e zyrës;(iii)Pajisjet Informatike llogaritet me **metodën e amortizimit të vlerës së mbetur** sipas normave fiskale duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes.

Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

4.7 Aktivet afatgjatë jo-materiale

Aktivitet afatgjatë jo-materiale të blera nga shoqëria paraqiten me koston historike minus amortizimin e akumuluar dhe çdo humbje tjetër nga rënia në vlerë(nëse ka), bazuar në jetëgjatësinë e vlerësuar pas datës së cilës ato janë te gatshme për përdorim. Jetëgjatësia dhe metoda e amortizimit të aktiveve jo-materiale shqyrtohet në çdo datë të pasqyrës së pozicionit financiar dhe efektet e ndryshimit merren parasysh në periudhat e ardhshme.

Kategoritë	Metoda e amortizimit	Norma e amortizimit
Programe kompjuterike	Mbi vlerer e mbetur	25%
Licensa	Metoda linare	15%

Shpenzimet e kërkimit dhe zhvillimit

Shpenzimet e kryera për zhvillimin e projekteve (Aktivet afatgjata jo-materiale) të blera nga Shoqëria janë paraqitur me kosto të pakësuar me amortizimin dhe humbjet e akumuluar të rënies në vlerë (SNK 38), duke konsideruar mundësinë komerciale dhe teknologjike, ku edhe koston mund të maten në mënyrë të besueshme. Shpenzimet vijuese të aktiveve afatgjata të patrupëzuara kapitalizohen vetëm kur rrisin përfitimet e ardhshme ekonomike nga aktivitetet specifike me të cilat lidhen. Të gjitha shpenzimet e tjera shpenzohen në momentin që ndodhin.

4.8 Aktive investuese

Aktivitet investues është aktiv i mbajtur për t'u dhënë me qira dhe/ose rivlerësimi i kapitalit (përfshirë aktivitet në ndërtim për qëllime të tilla), fillimisht maten me kosto, përfshirë koston e transaksionit. Ato fillimisht njihen në pasqyrën e pozicionit financiar kur risqet dhe përfitimet e pronësisë transferohen në Shoqëri pavarësisht nëse titulli është transferuar apo jo. Fillimisht maten me kosto. Pas periudhës së njohjes, aktivitetet e investimit maten me modelin e koston. Zhvlerësimi i këtyre aktiveve të investimit llogaritet bazuar në vlerën e tyre të mbetur. Aktivitetet e investimeve të

mbajtura nga një qiramarrës si një aktiv i përdorimit të drejtë maten fillimisht me koston në përputhje me SNRF 16.

4.9 Zhvlerësimi i aktiveve jo-financiare

Vlera kontabël e aktiveve jo-financiare të Shoqërisë, përveç inventarëve dhe aktiveve tatimore të shtyra rishikohen në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka të dhëna për zhvlerësimin e tyre. Nëse ka të dhëna të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivit.

Vlera e rikuperueshme e një aktivi është më e madhja midis vlerës së tij në përdorim dhe vlerës së tij të drejtë minus kostot e shitjes. Gjatë vlerësimit të vlerës në përdorim, flukset e ardhshme të pritura të parasë skontohehen në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike për aktivin. Me qëllim që të testohet zhvlerësimi, aktivet që nuk mund të testohen individualisht janë grupuar bashkë në Shoqëriën më të vogël të aktiveve që gjeneron flukse hyrëse të parave nga përdorimi i vazhdueshëm i aktiveve që janë kryesisht të pavarura nga flukset hyrëse të aktiveve të tjera ose grupeve të tjera të aktiveve (njësia e gjenerimit të parasë)(NJGJP).

Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera kontabël e një aktivi të tij tejkalon vlerën e tij të rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje. Humbjet e njohura nga zhvlerësimi i NJGJP shpërndahen duke pakësuar vlerat kontabël të aktiveve në njësi në mënyrë përpjesëtimore.

Humbjet nga zhvlerësimi vlerësohen në çdo datë raportimi nëse ka ndonjë tregues që humbja është zvogëluar apo nuk ekziston më. Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse ka pasur një ndryshim në vlerësimet e përdorura për të përcaktuar vlerën e rikuperueshme. Një humbje nga zhvlerësimi rimerret vetëm deri në masën që vlera kontabël e aktivit nuk tejkalon vlerën kontabël që do të ishte përcaktuar pasi të zbritej amortizimi, nëse nuk do të ishte njohur ndonjë humbje nga zhvlerësimi.

4.10 Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Modeli i zhvlerësimit në SNRF 9 bazohet në modelin e humbjeve të pritshme të kreditit ("ECL") dhe zëvendëson modelin e humbjeve të pësura të SNK 39, duke rezultuar në njohjen e një provigjoni humbjesh përpara se të ndodhë humbja e kreditit. Sipas kësaj qasje, shoqëria merr në konsideratë kushtet aktuale dhe informacionin e arsyeshëm që është në dispozicion pa kosto ose përpjekje të panevojshme gjatë vlerësimit të humbjeve të pritura të kreditit. SNRF 9 përcakton një "Qasje të Përgjithshme" për zhvlerësimin. Modeli ECL zbatohet për instrumentet financiare të regjistruara me koston e amortizuar ose me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse. Parimi udhëzues i modelit ECL është të pasqyrojë modelin e përgjithshëm të përkeqësimit, ose përmirësimit, në cilësinë e kredisë së instrumenteve financiare.

Një aktiv financiar i mbajtur jo me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes vlerësohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka evidence objektive që ai është zhvlerësuar. Një aktiv financiar zhvlerësohet nëse të dhëna objektive tregojnë se ka ndodhur një ngjarje e cila ka sjelle humbje pas njohjes fillestare të aktivit, dhe kjo ngjarje ka pasur efekt negativ mbi flukset monetare të parashikuara nga ai aktiv që mund të matet në mënyrë të besueshme.

4.11 Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

Të ardhura nga shitja e energjisë elektrike

Të ardhurat nga shitja e energjisë elektrike njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve bazuar në sasinë aktuale të energjisë elektrike të shitur. TEC-Vlora nuk ka prodhim energjie .

4.12 Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

4.13 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat e interesit nga fondet e investuara dhe fitimet nga kursi i këmbimit. Të ardhurat nga interesi njihen kur maturohen në fitim ose humbje, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Fitimet dhe humbjet nga kursi i këmbimit si edhe fitimet ose humbjet nga huatë me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes raportohen mbi bazë neto.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit mbi huatë dhe njihen në fitim ose humbje duke përdorur metodën e interesit efektiv.

4.14 Tatimi mbi fitimin

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin përfshin tatimin për periudhën dhe tatimin e shtyrë. Tatimi mbi fitimin e periudhës dhe tatimi i shtyrë njihen drejtpërdrejt në fitim ose humbje përveç rasteve kur lidhen me zëra që njihen drejtpërdrejt në kapital, ose në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse.

Tatimi mbi fitimin e periudhës është tatimi i pritshëm për t'u paguar ose arkëtuar mbi të ardhurat e tatueshme të vitit, duke përdorur normat tatimore në fuqi në datën e raportimit, dhe çdo rregullim të tatimit të pagueshëm nga vitet e mëparshme. Tatimi i shtyrë njihet, duke marrë në konsideratë diferencat e përkohshme midis vlerës kontabël të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerës së përdorur për qëllime tatimore. Tatimi i shtyrë nuk njihet për njohjen fillestare të aktiveve apo detyrimeve në një transaksion që nuk është një kombinim biznesi, dhe që nuk ndikon fitimin ose humbjen kontabël dhe as atë tatimore.

Matja e tatimit të shtyrë reflekton pasojat tatimore që do të ndjekin mënyrën në të cilën Shoqëria pret, në fund të periudhës raportuese, për të rimarrë ose shlyer vlerën kontabël neto të aktiveve dhe detyrimeve të saj.

Tatimi i shtyrë llogaritet me normat tatimore që pritet të jenë të zbatueshme ndaj diferencave të përkohshme kur ato rimerren, bazuar në legjislacionin në fuqi në datën e raportimit.

Aktivet dhe detyrimet e shtyra tatimore netohen mes tyre nëse ekziston një e drejtë e rregulluar me ligj për të netuar detyrimet dhe aktivet tatimore të periudhës, dhe kur ato lidhen me tatime që vendosen nga i njëjti autoritet tatimor mbi të njëjtin subjekt tatimor, ose mbi subjekte të ndryshme tatimore, por që kanë për qëllim të shlyejnë detyrimet dhe aktivet tatimore të periudhës në baza neto, ose aktivet dhe pasivet e tyre tatimore do të realizohen në të njëjtën kohë.

Taksat e tjera që rrjedhin nga shpërndarja e dividendëve nga Shoqëria njihen në të njëjtën kohë si detyrimi për të paguar dividendin e lidhur me të.

Një aktiv tatimor i shtyrë për humbje tatimore të papërdorura, njihet deri në masën që është e mundshme që të ekzistojnë përfitime të ardhshme të tatueshme kundrejt të cilave diferencat e përkohshme mund të përdoren. Aktivet tatimore të shtyra rishikohen në çdo datë raportimi dhe reduktohen në masën që nuk është më e mundshme që përfitimi tatimor në lidhje me to të realizohet

4.15 Qiratë

Qiratë në të cilat një pjesë e rëndësishme e rreziqeve dhe përfitimeve të pronësisë mbahen nga qiradhënësi klasifikohen si qira operative. Pagesat e qirave operative (pasí zbriten stimujt e pranuar nga qiradhënësi) njihen me metodën lineare në fitim ose humbje përgjatë periudhës së qirasë.

4.16 Përfitimet e punonjësve

Fondet e sigurimeve shoqërore, pensionale dhe të shëndetit

Sipas legjislacionit shqiptar në fuqi shoqëria është e detyruar të kryejë kontribute fikse për llogari të punonjësve në një fond të administruar nga qeveria. Të gjitha këto pagesa/detyrime njihen si shpenzim në periudhën të cilës i përkasin.

Përfitimet në përfundim të marrëdhënieve të punës

Sipas kontratës kolektive të punës, në rast të përfundimit të kontratës së punësimit pasí punonjësi ka arritur moshën e kërkuar me ligj për daljen në pension, pavarësisht nga arsyeja e përfundimit, punonjësi ka të drejtën e një kompensimi prej 2 pagash mujore bruto.

Përfitimet në përfundimin e kontratës njihen si shpenzim kur shoqëria është e përkushtuar pandojë mundësi realiste tërheqje ndaj një plani formal dhe të detajuar që të përfundojë kontratën përpara datës normale të daljes në pension ose të sigurojë përfitimet e përfundimit si rezultat i një oferte për të përkrahur sigurimin vullnetar. Përfitimet në përfundimin e kontratës për sigurimet vullnetare njihen si një shpenzim nëse shoqëria ka bërë një ofertë për sigurimin vullnetar dhe është e mundshme që oferta do pranohet dhe numri i pranimeve mund të matet në mënyrë të besueshme.

4.17 Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

4.18 Aktivitetet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

5. Aktivet afatgjata materiale

Vlera bruto e AAM me 31.12.2018	Toka	Ndërtime	Ndërtime & Instalime	Makineri dhe pajisje	Mjete Transporti	Pajisje informatike	Inventar ekonomik	Total
-	-	243.037.367	2.354.562.445	10.616.331.602	2.729.973	2.186.179	3.041.614	13.221.889.179
Shtesa gjate 2019								
Pakesime								
Vlera bruto e AAM me 31.12.2019	-	243.037.367	2.354.562.445	10.616.331.602	2.729.973	2.186.179	3.041.614	13.221.889.179
Amortizimi i akumuluar 31.12.2018		35.240.417	651.523.495	3.590.939.033	2.364.815	1.533.300	2.309.122	4.283.910.182
Pakesime								
Amortizimi i vitit 2019		4.860.747	90.910.255	487.989.584	73.032	163.220	146.499	584.143.337
Amortizimi i akumuluar, 31 dhjetor 2019	-	40.101.165	742.433.751	4.078.928.617	2.437.846	1.696.519	2.455.620	4.868.053.518
Vlera neto e AAM 2019	-	202.936.203	1.612.128.694	6.537.402.984	292.127	489.660	585.994	8.353.835.661
Vlera neto e AAM 2018	-	207.796.950	1.703.038.949	7.025.392.568	365.158	652.879	732.493	8.937.978.998

Për Ndërtime, Ndërtime dhe Instalime, Makineri e pajisje amortizimi llogaritet sipas viteve të jetgjatësisë, ndërsa për Mjetet e transportit, inventaret Ekonomik amortizimi llogaritet sipas normave fiskale.

Shënime: Amortizimi i aktiveve llogaritet me metodë lineare sipas jetës së vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjatë material për: (i) Ndërtesa; (ii) Ndërtesa dhe Instalime; (iii) Makineritë e Pajisjet duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes, Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2019 dhe 2018 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Amortizimi
Ndërtesa	50 vite
Ndërtime dhe instalime	20-50 vite
Makineri dhe pajisje	15-25 vite

Kjo metodë zbatohet për asetet e transferuara nga KESH sh.a. ne vitin 2012. Ekziston një grup asetesh në klasën Makineritë e Pajisjet të cilat janë blerë nga shoqëria në vite, amortizimi i të cilave llogaritet me metodën e amortizimit të vlerës së mbetur. Ndërsa: (i) Mjetet e Transportit; (ii) Pajisjet e zyrës; (iii) Pajisjet Informatike llogaritet me metodën e amortizimit të vlerës së mbetur sipas normave fiskale duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes.

6. Inventarë

Balancat e inventarit më 31 Dhjetor 2019 dhe 2018 paraqitet si më poshte:

	<u>31.12.2019</u>	<u>31.12.2018</u>
Nafta	1.106.865.768	1.107.596.246
Materiale	82.103.616	85.603.533
Invenar imet	117.335	117.335
Shuma	1.189.086.719	1.193.317.114
Zbritje per Inventaret		
Zbritje Inventari	(50.514.797)	(52.586.816)
Rimarrje per Inventaret	(154.800)	-
Zbritje Nafta	(418.096.735)	(253.769.849)
Shuma	(468.766.332)	(306.356.665)
Totali	<u>720.320.387</u>	<u>886.960.449</u>

7. Llogari të arkëtueshme e të tjera arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme detajohen si më poshtë:

	<u>31.12.2019</u>	<u>31.12.2018</u>
Te tjera te arketueshme (TVSH)	37.698.820	30.813.725
Tatim Fitimi		
Te tjera te arketueshme	32.292	103.792
Tatim Fitimi	44.797.486	37.811.116
Akciza per tu rimbursuar	825.781.559	825.781.559
<i>Zhvleresim i kerkeses per arketim per akcizen e naftes</i>	<i>(825.781.559)</i>	<i>(825.781.559)</i>
	<u>82.528.598</u>	<u>68.728.633</u>

8. Shpenzime për t'u shpërndarë

	<u>31.12.2019</u>	<u>31.12.2018</u>
Shpenzime për tu shperndarë	-	28.501.534
	<u>-</u>	<u>28.501.534</u>

9. Mjetet monetare

Gjendja e mjeteve monetare më 31 Dhjetor 2019 dhe 2018 paraqitet si më poshtë:

	<u>31.12.2019</u>	<u>31.12.2018</u>
Mjete monetare ne banke ne monedha te huaja (depozita)	614.570.002	622.187.888
Mjete monetare ne banke ne LEKE (depozita)	60.257.273	59.650.812
Mjete monetare ne banke ne monedhe huaj	345.580	7.817
Mjete monetare ne banke ne Leke	5.887.039	4.511.566
Mjete monetare ne arke	-	-
	<u>681.059.894</u>	<u>686.358.084</u>

Kushtet financiare per llogarinë depozitë:

1- shuma 5,046,973.82 Euro ; afati 6-mujore; norma interesit me baza vjetore 0.23

2- shuma 60,257,273.05 lekë; afati 6 –mujor ; norma interesit me bazë vjetore 1.1%

Shoqëria nuk ka realizuar vlerësime sipas IFRS 9.

10. Kapitali

Kapitali i Shoqërisë është në vlerën 31,204,000 Lekë i ndarë në 31,204 aksione me vlerë nominale 1,000 Lekë për aksion. Aksionet zotërohen 100% nga Korporata Elektroenergjitike Shqiptare .

Rezervat ligjore nuk kanë pësuar ndryshime , ato janë në vlerën 1,560,200 Lekë.

Rezervat e tjera të Shoqërisë nuk kane pasur ndryshime dhe janë në vlerën 225,747,682 Lekë .

Fitim/humbjet e mbartura janë në në vlerën (3,397,745,810)Lekë [2018: (3,57,833,142) Lekë].

Fitim/humbjet e vitit ushtrimore është në vlerën (911,055,149)Lekë [2018:(339,912,668)Lekë].

11. Hua afatgjata

Huatë afatgjata më 31 Dhjetor 2019 dhe 31 Dhjetor 2018 detajohen si më poshtë :

	<u>31.12.2019</u>	<u>31.12.2018</u>
Hua afatgjata	2.201.303.745	2.903.557.527
	<u>2.201.303.745</u>	<u>2.903.557.527</u>

Më 31 dhjetor 2019, huatë në shumën 2,201,303 mijë Lekë (2018: 2,903,557 mijë Lekë), mbartin norma interesi më të ulëta se normat e tregut dhe kanë afate maturimi afat gjatë[nënkonaluar nga KESH] shoqëria i nuk ka njohur huatë në përputhje me SNRF 9.

12. Grante, të ardhura të shtyra dhe të tjera detyrime

Balanca e granteve të ardhurave të shtyra dhe të tjera detyrimeve më 31 Dhjetor 2019 dhe 2018 paraqitet si më poshtë:

	<u>31.12.2019</u>	<u>31.12.2018</u>
Grante,te ardhura te shtyra e te tjera detyrime	52.642.901	54.715.243
	<u>52.642.901</u>	<u>54.715.243</u>

13. Hua afatshkurtra nga KESH sh.a

Huatë afatshkurtra të Shoqërisë më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 detajohen si më poshtë:

	<u>31.12.2019</u>	<u>31.12.2018</u>
Hua afat shkurter	9.860.856.697	9.268.069.251
Interesa te huave	938.010.660	820.875.559
	<u>10.798.867.357</u>	<u>10.088.944.810</u>

Shoqëria nuk ka realizuar vlerësime sipas IFRS 9.

13.1 Financime nga KESH-i.

	<u>31.12.2019</u>	<u>31.12.2018</u>
Financime te tjera nga KESH sh.a.	660.438.473	540.452.020
Siguracion asetesh (KESH SH.A.)	96.158.000	96.158.000
Sherbim rojesh (KESH SH.A.)	2.481.553	2.481.553
Financim Energji Elektrike nga KESH	22.771.605	17.124.658
KESH sh.a. karburant per automjetet	785.209	785.209
KESH SH.A.-Transferim shpenzimesh per	7.601.818	7.601.818
KESH SH.A. - Transferim shpenzimesh per FEE	3.412.177	1.717.221
	<u>793.648.835</u>	<u>666.320.479</u>

14. Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 detajohen si më poshtë :

	<u>31.12.2019</u>	<u>31.12.2018</u>
Furnitore vendas	2.228.458	4.044.672
Furnitore te huaj	19.258.498	19.519.453
	<u>21.486.956</u>	<u>23.564.125</u>

15. Detyrimet tatimore

Detyrimet tatimore të kompanisë më 31 Dhjetor 2019 dhe 2018 detajohen si më poshtë :

	<u>31.12.2019</u>	<u>31.12.2018</u>
Sigurime shoqerore e shendetesore	1.357.028	1.380.340
Tatim mbi te ardhurat personale	404.461	995.816
Tvsh per tu paguar(neto)	-	-
Tatim Burim	30.291	49.500
Shteti tatim fitimi	-	-
	<u>1.791.780</u>	<u>2.425.655</u>
Numri punonjesve	<u>62</u>	<u>62</u>

16. Detyrime të tjera

Detyrime të tjera më 31 Dhjetor 2019 dhe 2018 përbëhen si më poshtë:

	<u>31.12.2019</u>	<u>31.12.2018</u>
Paga per tu paguar personelit	4.009.324	3.509.125
Procese gjyqesore	13.919.532	4.351.477
Honorare per KM	171.649	171.649
Personeli-detyrime te kerkuara	10.000	20.000
Detyrime te tjera	88.200	88.200
Detyrime te Tjera	93.336	93.336
	<u>18.292.041</u>	<u>8.233.787</u>

17. Të ardhura nga shitja

Të ardhurat nga shitja e energjisë dhe të ardhurat e tjera për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019 dhe 2018 detajohen si më poshtë :

	<u>31.12.2019</u>	<u>31.12.2018</u>
Te ardhura nga shitja e energjise	-	-
	<u>-</u>	<u>-</u>

18. Të ardhura të tjera

Të ardhurat e tjera të Shoqërisë për 31 Dhjetor 2019 dhe 2018 detajohen si më poshtë :

	<u>31.12.2019</u>	<u>31.12.2018</u>
Rimarrje subvencionit për AAM të falura	309.923	387.480
Rimarrje subvencionit për materiale të falur nga Italianet	1.762.419	1.507.166
Te ardhura nga stornimi detyrimit ndaj OSHEE për periudhën 2012-2017	809.404	-
Gjoha të perfituara nga Tatimet	6.986.370	
Rimarrje të shumave të parashikuara për zhvleresim	154.800	
Sistemim veprimi të vitit të kaluar-Kesh Sh.a	4.801.371	
	<u>14.824.287</u>	<u>1.894.646</u>

19. Materiale të para dhe të konsumueshme

Shpenzimet për materialet e para dhe të konsumueshme për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019 dhe 2018 janë si më poshtë :

	<u>31.12.2019</u>	<u>31.12.2018</u>
Materiale të para	730.478	552.944
Materiale ndihmës	111.600	16.200
Pjesë ndërrimi	1.497.090	5.892.248
Kimikate	3.323.096	3.327.677
Pajime sigurie	11.200	41.710
Materiale - elektrike	309.935	761.740
Materiale - Mekanike	464.972	452.765
Materiale - hidraulike	44.960	57.880
Materiale - Zyre	174.639	165.051
Materiale -Mirembajtje e sistemeve	162.300	262.500
Materiale për linjen e furnizimit në det	-	37.600
Karburant për makinat	2.051.513	2.133.025
Vajra lubrifikante dhe vajra transformatori	1.212.820	293.650
Inventar i imet	-	1.958
Materiale të tjera	(711.356)	3.706.833
	<u>9.383.248</u>	<u>17.703.779</u>

20. Shpenzime personeli

Shpenzimet e personelit për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019 dhe 2018 detajohen si më poshtë:

	<u>31.12.2019</u>	<u>31.12.2018</u>
Pagat bruto	53.083.417	52.822.801
Kontribute sigurmi shoqerore	9.899.219	9.822.290
Shpenzime te tjera per personelin	<u>8.506.500</u>	<u>12.279.095</u>
	<u>71.489.135</u>	<u>74.924.186</u>

21. Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi

Shpenzimet e amortizimit për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019 dhe 2018 detajohen si më poshtë:

	<u>31.12.2019</u>	<u>31.12.2018</u>
Amortizimi i AAM	584.143.337	584.756.973
Shpenzime zhvleresimi te arketueshe	<u>178.246.418</u>	<u>258.367.176</u>
	<u>762.389.755</u>	<u>843.124.149</u>

22. Shpenzimet e tjera të shfrytëzimit detajohen si më poshtë:

	<u>31.12.2019</u>	<u>31.12.2018</u>
Blerje energji ,avull,uje,tj	5.136.477	3.280.284
Mirembajtje dhe riparime	11.501.397	6.211.823
Shpenzime siguracione	28.501.534	29.168.965
Sherbime te tjera	3.228.153	10.269.030
Sherbim i ruajtjes dhe sigurise	10.449.685	9.288.576
Personel jashtë njesisë	2.423.280	2.423.280
Transferime, udhëtime, dieta	560.500	483.380
Shpenzime postare dhe telekomunikimi	128.814	192.680
Shpenzime transporti	1.222.522	1.233.794
Shpenzime për shërbimet bankare	110.699	107.571
Gjoha dhe dëmshpërblime	490.965	3.802.025
	<u>63.754.025</u>	<u>66.461.407</u>

Shenim: Shpenzime auditimi

Fatime Alliu	862.500	990.000
Ermir Veipi	862.500	-
Ilir Daiu		990.000

23. Shpenzime interesi dhe të ngjashme e të tjera financiare

Shpenzimet e interesit dhe të ngjashme për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019 dhe 2018 detajohen si më poshtë:

	<u>31.12.2019</u>	<u>31.12.2018</u>
Te ardhura nga interesat e llog. bankare	1.657.098	2.282.877
Shpenzime nga interesat e llog.bankare	(4.716)	(3.789)
Shpenzime per interesa kredie afat gjate	(130.469.739)	(164.563.013)
Shpenzime nga vlersime te kursit kembimit valutore	(28.159.298)	(47.954.208)
Te ardhurat nga vlersimi kursit kembimit valutore	138.113.382	870.644.339
	<u>(18.863.273)</u>	<u>660.406.206</u>

24. Rezultati Tatimore

Përlllogaritja e rezultatit tatimore 2019 paraqitet si më poshtë :

	<u>31.12.2019</u>	<u>31.12.2018</u>
Fitimi (Humbje) para Tatimit	<u>(911,055,149)</u>	<u>(339,912,668)</u>
Shpenzime te panjohura (Gjoha e interesa tatimore)	490,965	3,802,025
Shpenzime te panjohura te tjera	411,929,572	493,200,019
Humbje e mbartur nga viti kaluar	(677,829,819)	(1,436,161,224)
Fitimi (Humbje) Tatimore	<u>(1,176,464,431)</u>	<u>(1,279,071,849)</u>
Tatimi mbi Fitimin (15 %)	-	-
Fitimi (Humbje) NETO	<u>(911,055,149)</u>	<u>(339,912,668)</u>

25. Transaksionet me palët e lidhura

Transaksionet me palët e lidhura me impakt në pasqyrën e pozicionit financiar dhe në pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse paraqiten si më poshtë :

	31 Dhjetor 2019		31 Dhjetor 2018	
	Të arketueshme	Të Pagueshme	Të arketueshme	Të Pagueshme
KESH sha		13,793,819,937	-	13,658,822,816
KESH Kredia WB 38720 USD	-	2,558,421,278	-	2,539,110,661
KESH Kredia EBRD 33833 euro	-	4,717,439,603	-	4,781,361,549
KESH Kredia EIB 22706 euro	-	4,786,299,561	-	4,851,154,568
KESH Detyrim per interesa te kredise WB 38720 USD	-	186,430,037	-	137,343,071
KESH Detyrim per interesa te kredise EBRD	-	66,957,743	-	67,791,085
KESH Detyrime per interesat e kredise EIB 22706 Euro	-	684,622,880	-	615,741,403
Financime KESH SH.A.	-	660,438,473	-	540,452,020
Siguracion asetesh (KESH SH.A.)	-	96,158,000	-	96,158,000
Sherbim rojesh (KESH SH.A.)	-	2,481,553	-	2,481,553
Financim Energji Elektrike nga KESH	-	22,771,605	-	17,124,658
KESH sh.a. karburant per automjetet	-	785,209	-	785,209
KESH SH.A. - Transferim shpenzimesh per sistemet IT		7,601,818		7,601,818
KESH SH.A. - Transferim shpenzimesh per FEE transmetim energjie		3,412,177		1,717,221
TOTALI		13,793,819,937		13,658,822,816

Të tjera informacione për palët e lidhura.

Transaksione	Viti 2019		Viti 2018	
	Shitje	Blerje	Shitje	Blerje
Energji nga KESH sh.a.	-	5,667,956.21	-	3,434,442.18
Tarife transmetimi l energjise	-	1,694,956.02	-	1,717,220.53
TOTALI	-	7,362,912	-	5,151,663

	31.12.2019	31.12.2018
Administrator	1.800.000	1.800.000
Keshilli Mbikqyres	2.423.280	2.130.000
	<u>4.223.280</u>	<u>3.930.000</u>
	Nr	Nr
Administratore	1	1
Keshill Mbikqyres	7	7
	<u>8</u>	<u>8</u>

26. Manaxhimi i riskut financiar

Detyrimet financiare kryesore të Shoqërisë përbëhen nga llogaritë e pagueshme dhe të tjera detyrime. Qëllimi kryesor i këtyre detyrimeve financiare është të financojnë operacionet e Shoqërisë dhe të sigurojnë garanci për mbështetjen e operacioneve. Shoqëria ka hua, llogari të arkëtueshme, mjete monetare dhe depozita afatshkurtra që sigurohen drejtpërdrejtë nga operacionet e saj. Shoqëria është e ekspozuar ndaj riskut të tregut, riskut të kreditit dhe riskut të likuiditetit.

Manaxhimi i lartë i Shoqërisë mbikqyr manaxhimin e këtyre risqeve.

Risku i tregut

Risku i tregut është risku që vlera e drejtë e flukseve monetare të ardhshme të një instrumenti financiar do të variojë për shkak të ndryshimeve në çmimet e tregut. Çmimet e tregut përfshijnë katër lloje risqesh: risku i normës së interesit, risku i kursit të këmbimit, risku i çmimit të mallrave dhe risqe të tjera të çmimeve, të tilla si risku i çmimit të kapitalit. Instrumentat financiar të prekur nga risku i tregut përfshijnë huatë, kreditë dhe depozitat.

Risku i normave të interesit

Risku i normës së interesit përbëhet nga risku që vlera e flukseve monetare të ardhshme të një instrumenti financiar do të variojë për shkak të ndryshimeve në normat e interesit në treg dhe riskut që maturitetet e aktiveve që mbartin interes të ndryshojnë nga maturitetet e detyrimeve që mbartin interes të përdorura për të financuar ato aktive. Zgjatja kohore përgjatë të cilës norma e interesit e një instrumenti financiar është fikse, përcakton se në çfarë mase është e ekspozuar ndaj riskut të normës së interesit.

Aktivitet dhe detyrimet e Shoqërisë mbartin risk të normave të interesit.

	31.12.2019	31.12.2018
Instrumenta me interes fikse		
Aktive Financiare	-	-
Detyrime Financiare	-	-
	-	-
Instrumenta me interes variabel		
Aktive Financiare		
Detyrime Financiare	12.062.160.442	12.171.626.778
	12.062.160.442	12.171.626.778

Risku i kreditit

Risku i kreditit është risku që një palë tjetër nuk do të jetë në gjendje të paguajë detyrimet e saj që rrjedhin nga një instrument financiar ose marrëveshje klienti, duke çuar kështu në një humbje financiare. Shoqëria është e ekspozuar ndaj riskut të kreditit për shkak të aktiviteteve operacionale të saj (pikë së pari prej llogarive të arkëtueshme) dhe prej aktiviteteve të saj financuese, që përfshijnë depozitat me bankat dhe institucionet financiare, transaksionet në monedha të huaja dhe instrumenta të tjerë financiare.

Risku i kreditit është i kufizuar në vlerën kontabël të aktiveve financiare në datën e raportimit.

Risku i Likuiditetit

Risku i likuiditetit është risku që Shoqëria mund të mos jetë në gjendje të paguajë detyrimet e saj të lidhura me detyrimet financiare në momentin e pagesës. Risku i likuiditetit është risk i qenësishëm në biznesin e Shoqërisë pasi disa aktive specifike të blera apo detyrime të shitura mund të kenë karakteristika likuiditeti që janë specifike. Nëse Shoqërisë do ti duhet të ketë shuma të mëdha në një afat të shkurtër kohor që tejkalon kërkesat normale për mjete monetare mundet që të ndeshet me vështirësi për të siguruar çmime konkurruese. Shoqëria manaxhon riskun e

likuiditetit duke monitoruar në mënyrë të vazhdueshme parashikimet dhe flukset monetare aktuale dhe duke u munduar të përputhë profilet e maturitetit të aktiveve dhe detyrimeve.

	Nga 1 deri në 12 muaj	Nga 1 deri në 5 vjet	Më shumë se 5 vjet	Totali
31 Dhjetor 2018				
Llogari të arkëtueshme e të tjera	68.728.633	-	-	68.728.633
Shpenzime ter tu shpermdare	28.501.534	-	-	28.501.534
Mjetet monetare në arkë e në bankë	686.358.084	-	-	686.358.084
shuma	783.588.251	-	-	783.588.251
Detyrimet e pagueshme të tjera	(34.223.567)	-	-	(34.223.567)
Interesa KESH	(820.875.559)	-	-	(820.875.559)
Financime KESH SH.A.	(540.452.020)	-	-	(540.452.020)
Siguracion asetesh (KESH SH.A.)	(96.158.000)	-	-	(96.158.000)
Sherbim rojesh (KESH SH.A.)	(2.481.553)	-	-	(2.481.553)
Financim Energji elektrike	(17.124.658)	-	-	(17.124.658)
KESH sh.a. karburant per automjetet	(785.209)	-	-	(785.209)
KESH SH.A. - Transferim shpenzimesh per sistemet IT	(7.601.818)	-	-	(7.601.818)
KESH SH.A. - Transferim shpenzimesh per FEE transmetim energjie	(1.717.221)	-	-	(1.717.221)
Huate	(9.268.069.251)	(2.540.827.433)	(362.730.094)	(12.171.626.778)
shuma	(10.789.488.856)	(2.540.827.433)	(362.730.094)	(13.693.046.383)
Rreziku I likuiditetit më 31 dhjetor 2018	(10.005.900.605)	(2.540.827.433)	(362.730.094)	(12.909.458.132)

	Nga 1 deri në 12 muaj	Nga 1 deri në 5 vjet	Më shumë se 5 vjet	Totali
31 Dhjetor 2019				
Llogari të arkëtueshme e të tjera	82.528.598	-	-	82.528.598
Shpenzime ter tu shpermdare	-	-	-	-
Mjetet monetare në arkë e në bankë	681.059.894	-	-	681.059.894
shuma	763.588.492	-	-	763.588.492
Detyrimet e pagueshme të tjera	(41.570.777)	-	-	(41.570.777)
Interesa KESH	(938.010.660)	-	-	(938.010.660)
Financime KESH SH.A.	(660.438.473)	-	-	(660.438.473)
Siguracion asetesh (KESH SH.A.)	(96.158.000)	-	-	(96.158.000)
Sherbim rojesh (KESH SH.A.)	(2.481.553)	-	-	(2.481.553)
Financim Energji elektrike	(22.771.605)	-	-	(22.771.605)
KESH sh.a. karburant per automjetet	(785.209)	-	-	(785.209)
KESH SH.A.-Transferim shpenzimesh per sistemet IT	(7.601.818)	-	-	(7.601.818)
KESH SH.A. - Transferim shpenzimesh per FEE transmetim energjie	(3.412.177)	-	-	(3.412.177)
Huate	(9.860.856.697)	(2.018.559.368)	(182.744.377)	(12.062.160.442)
shuma	(11.634.086.969)	(2.018.559.368)	(182.744.377)	(13.835.390.714)
Rreziku I likuiditetit më 31 dhjetor 2019	(10.870.498.477)	(2.018.559.368)	(182.744.377)	(13.071.802.222)

Risku i monedhës

Shoqëria ndërmerr transaksione në monedhë të huaj si pasojë e ekspozimit ndaj luhatjeve të kurseve të këmbimit. Ekspozimi ndaj kurseve të këmbimit manaxhohet duke përcaktuar një politikë midis të arkëtueshmeve dhe të pagueshmeve. Vlera kontabël neto e aktiveve dhe detyrimeve monetare të shoqërisë sipas monedhave për vitin që u mbyll janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Termocentrali Vlorë sh.a
Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019
(Vlerat janë në Lek)

	Më 31 Dhjetor 2019			Më 31 Dhjetor 2018		
	Aktive financiare monetare	Detyrime financiare monetare	Pozicioni neto i bilancit	Aktive financiare monetare	Detyrime financiare monetare	Pozicioni neto i bilancit
LEK	148.672.910	835.219.612	(686.546.702)	161.392.545	700.544.045	(539.151.500)
EUR	614.915.582	10.255.319.787	(9.640.404.206)	622.195.706	10.316.048.605	(9.693.852.900)
USD		2.744.851.315	(2.744.851.315)		2.676.453.732	(2.676.453.732)
GBP			-			-
CHF			-			-
Totali	763.588.492	13.835.390.714	(13.071.802.223)	783.588.251	13.693.046.382	(12.909.458.131)

27. Angazhime dhe detyrime te kushtezuara

Detyrimet tatimore

Librat e Shoqërisë nuk janë audituar nga organet tatimore për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2019. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në mënyrë të besueshme.

28. Ngjarje pas datës së raportimit financiar

Në datën 30.01.2019 KESH sha. Si aksioner i vetëm i Tec .Vlora ka regjistruar pronësinë e tokës mbi të cilën është ndërtuar Termocentrali Vlora në ZVRPP Vlorë, Zona kadasale 8604 me Numer pasurie 47/89, volumni 39 faqe 118, lloji i pasurisë Pyll Vlore sipërfaqe 14,000 m2.

Toka nuk ka vlerë, kështu që nuk është përfshirë në pasqyrat financiare të datës 31 dhjetor 2019.


Nuk ka ngjarje të tjera të rëndësishme pas datës së raportimit të cilat do të kërkonin korrigjim ose shënime në pasqyrat financiare.

Ndërsa situata pandemike COVID-19 ende po evoluon në Shqipëri dhe në mbarë botën, ka pasiguri të lartë mbi shtrirjen e saj në kohën e lëshimit të këtyre pasqyrave financiare. Si pasojë, menaxhimi nuk është në gjendje të vlerësojë me siguri dhe të sigurojë një vlerësim sasior të ndikimit të mundshëm të kësaj pandemie në kompani.


Dorina KAMBERAJ
 Hartues i pasqyrave financiare



Eduard ALUSHI
 Drejtor i D. Ekonomike



Besnik KENDEZI
 Administrator i TEC Vlorë sh.a



Vlorë, më/...../2020

